



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	90103-02201-11-2019	Data e Regjistrimit :	11/07/2019
Numri i Vendimit:	11-2019-4127	Data e Vendimit :	17/07/2019

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Mimoza Margjeka

SEKRETARE: Joana Vargu

Sot më datë 17/07/2019mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket :

Kërkues Valbona Sako, e bija e Simo dhe i x, i datëlindjes 02/11/1970

Objekti:Verifikimi i mandatit të Kryetarit të Bashkisë.

Baza Ligjore:Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 60, pika 1.

Gjykata pasi analizoi provat shkresore dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi

VEREN :

Vëren:

Se kërkuesja Valbona Sako me datë 11.07.2019, ka paraqitur në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës, kërkuesën me objekt: *Verifikimin e mandati te Kryetarit te Bashkise Durrës.*

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesës, Gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështjeje. Në bazë të nenit 36/1 të K.Pr.C në të cilin parashikohet se: *“Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta”*, në rastin konkret, kompetenca e Gjykatës parashikohet në nenin 60 pika 1 e ligjit 139/2015 “ Për Qeverisjen Vendore” në të cilin parashikohet se:

‘Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij’.

Rrethanat e Faktit:

Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar se, në procesin zgjedhor për organet e qeverisjes vendore në datën 30.06.2019, në garën për Kryetar të Bashkisë Durrës, kanë marrë pjesë 2(dy) kandidatë si më poshtë:

- 1- Valbona Sakollari, Kandidate e subjektit zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”
- 2- Valbona Sako, Kandidate e Kalicionit, “Aleanca për Shqipërinë Evropiane”

Me vendimin nr. 944 datë 05.07.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur:

1. Të miratojë tabelën përmbledhëse të rezultateve, për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Të shpallë fituese për Kryetar të Bashkisë Durrës, Znj. Valbona Simo Sako, të propozuar nga Koalicioni “Aleanca Për Shqipërinë Evropiane”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë , brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Sipas vërtetimit nr. 13473/1 datë 11.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezulton se: *Pranë KQZ-së nuk është paraqitur asnjë kërkesë ankimore, ndaj vendimit nr. 944 datë 05.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës dhe shpalljen fitues të znj. Valbona Simo Sako.*

Në rrethanat e mësipërme kërkuesja Valbona Sako i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për vërtetimin e mandati te Kryetarit të Bashkisë Durrës, sipas nenit 60/1 të ligjit 139/2015 “ Për Qeverisjen Vendore”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Procesi Zgjedhor për Organet e Pushtetit vendor, fillon me caktimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës nëpërmjet Dekretit të tij.

Në neni 92/gj të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve; Sipas neni 21 te Kodit Zgjedhor, “Data e zgjedhjeve” është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.*

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese (neni 92/gj të Kushtetutes), Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka caktuar datën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore me Dekretin e Nr. 10928, datë 05.11.2018 *“Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore me date 30.06.2019”.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë organi më i lartë shtetëror i përhershëm i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Zgjedhor, në zbatim të Dekretit të Presidentit nr. 10928, datë 05.11.2018 ka filluar procedurat për organizimin e procesit zgjedhor për *Organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019[1].*

Gjykata, në këtë lloj gjykimi ka detyrim ligjor të verifikojë mandatin e Kryetarit të Bashkisë duke analizuar të gjithë procedurë administrative dhe ligjore në rastin konkret (për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Durrës).

Në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 Qershor 2019, për Kryetarë të Bashkinë Durrës, garojnë me kandidatë subjektet si më poshtë:

1. Subjekti zgjedhor Partia “Bindja Demokratike”
2. Subjekti zgjedhor Kalicioni, “Aleanca për Shqipërinë Evropiane

Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve (OSCE&ODHIR Republika e Shqipërisë – zgjedhjet vendore, 30 qershor 2019) në deklaratën e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake, citon si më poshtë :

“KQZ-ja demonstroi qartazi një qasje gjithëpërfshirëse në regjistrimin e kandidatëve. Ndonëse kjo rriti numrin e garuesve, KQZ-ja e interpretoi ligjin në një mënyrë tejte të gjerë dhe, ndonjëherë

jokonsistente, duke cenuar sigurinë juridike. KQZ-ja e regjistroi Bindjen Demokratike (BD) si subjekt zgjedhor më 27 prill, ndonëse kjo e fundit ishte regjistruar si parti politike vetëm më 25 prill me një vendim gjykate që mori formë të prerë më 10 maj”[2].

Nisur dhe nga konstatimi në deklaratën e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake, të Misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve (OSCE&ODHIR Republika e Shqipërisë – zgjedhjet vendore, 30 qershor 2019), Gjykata verifikoi ligjshmerinë e (akteve administrative) vendimeve të KQZ-së për rregjistrimin e subjekteve zgjedhore garuese, për mandatin e Kryetarit të Bashkisë Durrës.

Me vendimin nr. 148, datë 11.04. 2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur:

Të regjistrojë “Partia Socialiste e Shqipërisë”, kryetar z. Edi Rama, dhe shkronja nistore “PS”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendoretë datës 30 qershor 2019”.

Me vendimin nr 251, date 07.05. 2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur:

Të regjistrojë Koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”,(ASE) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Me vendimin nr. 230, date 27.04. 2019 Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur:

Të regjistrojë Partinë “Bindja Demokratike”, me kryetar z.Astrit Patozi, dhe shkronja nistore “BD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendoretë datës 30 qershor 2019”.

Në nenin 9, të Ligjit Nr.8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, të ndryshuar thuhet se:

1.Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrimit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues,shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent.

2.Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.

3.Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos,thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.

Në nenin 64 te Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, thuhet se:

1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ

:a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;

c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;

ç) specimenin e vulës së partisë;

d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë;

dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

Në nenin 65 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë thuhet se:

1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.

Sipas vendimit nr 148, datë 11.04. 2019 të KQZ-se rezultoi se, regjistrimi i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqiperise”, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 30.06.2019, është bërë , brenda afatit 70 (shtatëdhjetë) ditor të parashikuar, në nenin 64 të Kodit zgjedhor.

Sipas vendimit nr. 251, datë 07.05. 2019t e KQZ, rezultoi se, regjistrimi i Koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”,(ASE) si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes vendore, është bërë brenda afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të parashikuar, në nenin 64 të Kodit zgjedhor.

Gjykata konstaton se, vendimi nr. 230, datë 27.04. 2019 te KQZ-së për regjistrimin si subjekt zgjedhor te Partisë “Bindja Demokratike”, është marrë në shkelje të hapur me nenin 64 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 9 të Ligjit “Për Partitë Politike”(ligji material), dhe për rrjedhojë, konstatohet nga gjykata si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm[3], sipas neneve 108 dhe 109 të Kodit të Procedurave Administrative[4].

Në lidhje më këtë konstatim Gjykata arsyeton si më poshtë:

Afati për të paraqitur kërkesë nga partitë politike, është përcaktuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se: “Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve”.

- Bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet e datës 30.06.2019, afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga partitë politike, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ është përcaktuar data 23.04.2019, pasi data 21 si afat i fundit ishte ditë e Shtunë.

-Partia “Bindja Demokratike, me datën 23.04.2019 ka paraqitur kërkesë, pranë KQZ-së, për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të dates 30.06.2019.

-Regjistrimi në Gjykatë i Partisë “Bindja Demokratike” është bërë me vendimin nr 8, datë 25.04.2019 të Gjyqesës e Rrethit Gjyqësor Tirane,

vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 10.05.2019.

-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar kërkesën e Partisë Bindja Demokratike dhe ka bërë regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor, me vendimin e sipërcituar në kundërshtim me nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se:

2. Për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ

:a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;

-Në momentin e paraqitjes së kërkesës "Partia Bindja Demokratike", nuk kishte fituar akoma personalitetin juridik, pasi në mbështetje të nenit 9/2 të ligjit "Per Partite Politike", "Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë".

-Gjithashtu Partia "Bindja Demokratike", duke mos qene e regjistruar në Gjykate, në momentin e paraqitjes së kërkesës për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, nuk kishte zotesi juridike për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime, sikurse është marrja pjesë në zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

-Sa sipër, rezulton se Partia Bindja Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-s) në shkelje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 9 të Ligjit "Per Partite Politike".

-Për raste të ngjashme ka dhe precedentë të mëparshëm, në të cilat KQZ ka rrëzuar kërkesën e subjekteve politike për tu regjistruar si subjekte zgjedhore dhe për te marre pjese në zgjedhje, pa patur me parë, një vendim Gjykate të formës së prerë për regjistrimin e tyre në gjykatë. Shembull është vendimi nr. 158 datë 16.04.2015 me anë të të cilit KQZ-ja ka vendosur: *Të mos rregjistrojë në zgjedhje Partinë "Shkodra 2015", për të marrë pjesë në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 me arsyetimin se:*

Vendimi i rregjistrimit në Gjykatë merr formë të prerë jashtë afateve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor për regjistrimin e Partive Politike si subjekte zgjedhore.

-Partia "Bindja Demokratike" është regjistruar në Gjykatë me datën 25.04.2019, pasi kishte përfunduar afati për regjistrimin e subjekteve zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për zgjedhjet *për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.*

Gjykata, duke patur parasysh sa u parashtrua më lart dhe bazuar në nenin 9 të ligjit "Për Partitë Politike", në nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në nenet 108, 109 dhe 110 të Kodit të Procedurave administrative, konstaton si akte absolutisht të pavleshme aktet e mëposhtme:

1- *Vendimin nr 230, datë 27.04. 2019 të KQZ-së, Për regjistrimin e subjektit zgjedhor "Partia Bindja Demokratike" për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.*

2- *Vendimin nr 660, date 27.05.2019 të KQZ-së, Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Durrës për Zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.*

3- *Vendimin nr 944, datë 05.07.2019 të KQZ-së, Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkise Durrës, Qarku Durrës, në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019.*

Gjykata pasi analizoi çështjen në tërësi, arriti në përfundimin se, kërkesa e kërkueses Valbona Sako për vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Durrës duhet rrëzuar.

[1] Në nenin 21 të Kodit Zgjedhor janë të përcaktuara kompetencat e KQZ-së .

[2] Më 2013-ën dhe 2015-ën, KQZ-ja refuzoi regjistrimin e Partisë Civile të Shqipërisë dhe Partisë Shkodra 2015, të cilat nuk kishin paraqitur vendime të formës së prerë të gjykatës për regjistrimin e tyre si parti politike

[3] Neni 110

Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute

1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

[4] Neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Neni 109

Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

d) është në kundërshtim me ligjin material;

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata bazuar ne nenin 60 pika 1 e ligjit 139/2015 " Per Qeverisjen Vendore".

VENDOSI:

Vendosi:

VENDOSI:

-Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Valbona Sako për vërtetimin e mandatit të kryetarit të Bashkisë Durrës.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në gjykatën e Apelit Durrës brenda afatit ligjor 5 ditor,afat i cili fillon nga e nesërmeja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.
U shpall në Durrës më datë 17.07.2019

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	200
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:

Mimoza Margjeka